

URDHËR
Nr. 100, datë 10.2.2021

**PËR KUFIZIMIN E AKTIVITETEVE TË BAREVE, RESTORANTEVE, FAST FOOD
DHE LOKALEVE**

(Ndryshuar me udhërrëfshin nr. 136, datë 25.2.2021; nr. 208, datë 12.4.2021; nr. 564, datë 23.12.2021)

(I përditësuar)

Në zbatim të nenit 7, pika 4 germa “b” të ligjit nr. 15/2016 “Për parandalimin dhe luftimin e infeksioneve dhe sëmundjeve infektive”, udhëzimit të Institutit të Shëndetit Publik, si dhe në zbatim të vendimit të Komitetit të Përkohshëm për Infeksionin e Përhapur nga Coronavirus i ri nr. 809 datë 10.02.2020, me qëllim parandalimin e përhapjes së infeksionit të shkaktuar COVID-19 në Republikën e Shqipërisë dhe mbrojtjen e shëndetit të popullatës,

URDHËROJ:

1. Kufizimin e aktivitetit të bareve, restoranteve, fast food dhe lokaleve, që ofrojnë shërbim për klientët, nga ora 22:00 deri në orën 06:00, në të gjithë vendin, nga data 12.4.2021 deri në një urdhër të dytë.

1/1. Përfundim, nga rregulli i përcaktuar në pikën 1 të urdhrit, bëhet vetëm për natën e ndërrimit të viteve, datë 31.12.2021–1.1.2022.

2. Përfundim nga rregulli i përcaktuar në pikën 1, bëhet vetëm për shërbimin në banesë (*delivery*), i cili duhet të kryhet duke respektuar rregullat higjienike të miratuara.

3. Ngarkohen për zbatimin e këtij urdhri organet kompetente për dhënien e masave administrative sipas aktit normativ nr. 3, datë 15.3.2020 “Për marrjen e masave të veçanta administrative gjatë kohëzgjatjes së periudhës së shkaktuar nga COVID-19” i ndryshuar.

4. Çdo urdhër i mëparshëm në kundërshtim me këtë urdhër, shfuqizohet.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I SHËNDETËSISË
DHE MBROJTJES SOCIALE
Ogerta Manastirliu